



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 249, datë 09.06.2021**

**PËR**  
**KOMANDIMIN E GJYQTARES ZNJ. {...}**  
**NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

*(azhornuar me vendimin nr. 253, 07.07.2022)*

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>1</sup>, nenin 61, pika 2, shkronja “a”<sup>2</sup>, 86, shkronja “ë”<sup>3</sup> dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45<sup>4</sup>, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në *Vendimin nr.249, datë 09.06.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>5</sup>, si dhe në shkresën nr. 3820/1 Prot., datë 04.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm<sup>6</sup>*, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin “*Këshilltar Ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme*”<sup>7</sup>, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Periudha e komandimit është deri në tre vjet dhe fillon më datë 21.06.2021.
3. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit.
4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
5. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën e saj postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

<sup>1</sup> (shtuar fjalët “nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” me vendimin nr. 253, datë 07.07.2022)

<sup>2</sup> (shtuar togfjalëshi “pika 2, shkronja “a”, me vendimin nr. 253, datë 07.07.2022)

<sup>3</sup> (ndryshuar togfjalëshi “shkronja “d” me vendimin nr. 253, datë 07.07.2022)

<sup>4</sup> (ndryshuar togfjalëshi “nenin 54, pika 6”, me vendimin nr. 253, datë 07.07.2022)

<sup>5</sup> (ndryshuar togfjalëshi “Vendimin e tij nr. 200, datë 12.05.2021, “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandimin në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kushtet, kriteret dhe procedurën e komandimit, me vendimin nr. 253, datë 07.07.2022)

<sup>6</sup> (ndryshuar togfjalëshi “mbi kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcjellë me Shkresën nr. 2397/7 prot., datë 04.06.2021,” me vendimin nr. 253, datë 07.07.2022)

<sup>7</sup> (ndryshuar togfjalëshi “Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë”, me vendimin nr. 253, datë 07.07.2022)

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**